

Koordinator (Për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale për Qeverisjen e Sigurisë Kibernetike), në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/24 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Koordinator (Për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale për Qeverisjen e Sigurisë Kibernetike), në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Koordinim dhe shkëmbim i informacionit ndërmjet Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe institucioneve të tjera qeveritare, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe sektorit privat, për çështjet e sigurisë kibernetike;
- Mbështet drejtorinë e AKSK-së në përgatitjen e materialeve informuese dhe raporteve për diskutime në takime ndërinstitucionale;
- Koordinon hartimin dhe zbatimin e memorandumeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet AKSK-së dhe palëve të tjera;
- Informon Drejtorin e Përgjithshëm mbi politikën dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike;
- Ndihmon në hartimin e deklaratave zyrtare të institucionit;
- Koordinon dhe komunikon me mediat për çështje që lidhen me veprimtarinë e institucionit.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli i diplomës “Master Shkencor”, në Shkenca Politike, Ekonomike, Siguri Kibernetike, ose fusha të ngjashme.

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në bashkëpunim ndërinstitucional ose projekte ndërkombëtare.

FUSHA E NJOHURIVE DHE AFTËSITË:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Njohuri të thelluara mbi sfidat dhe politikat e sigurisë kibernetike;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe negocimi;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe preferohet njohja e një gjuhe tjetër të huaj;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (II-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 12.02.2025, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.